



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:081237

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05526552

P.nr.294/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren e vetëme gjykuese Mevlide Shabani, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Albinë Velekinca-Sadiku, në çështjen penale kundër të pandehurve A. S. nga Gjilani, me mbrojtësin e tij me autorizim avokatin Rr.L. nga Gjilani dhe të pandehurit B... G. nga L., me mbrojtësen e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokaten K. S. nga Gjilani, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 te KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.../2023, të datës 27.04.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datë 22.02.2024, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 22.03.2024, përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

B. G., nga babai H. dhe nëna H., e lindur P., i lindur me datë, në fshatin T., Komuna e L., me vendbanim në L., rr. "Z. G." ndërtesa- kati .., nr..., i pa martuar, i pa punë, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe

A. S., nga babai Sh. dhe nëna Q., e lindur M., i lindur me datë, në Gjilan, ku edhe jeton, rr. "H. K.", p.n., i martuar, baba i .. fëmijëve, ka kryer shkollën fillore, me profesion automekanik-p. i. nga Z., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

JANË FAJTOR

Sepse:

Me datë 09.01.2023, rreth orës 18:45 h, në rrugën " Ukshin Hoti", në Gjilan, të pandehurit, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për tjetrin, në bashkëveprim dhe me dashje kanë kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarit N. D., në atë mënyrë që duke përdorur forcën kanë hapur derën e ballkonit dhe dritares në katin e dytë të shtëpisë së të dëmtuarit dhe nga aty kanë marr para te metalta në vlerë prej një mijë (1000) euro, të cilat ishin nga 1 euro dhe 2

euro, si dhe orë dore, bizhuteri, parfume të ndryshme, ashtu që me tu hetuar nga i dëmtuari nga ballkoni i katit të dytë kërcejnë në tokë dhe largohen nga vendi i ngjarjes, të cilat i janë gjetur dhe sekuestruar pas urdhër kontrollit me numër UGJK.nr. ../2023 të datës 04.04.2023, nga zyrtarët policor me ç rast të pandehurit me veprimet e tyre, të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm material në vlerë prej 3400 euro.

-Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, **vjedhja**, nga neni 313, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

andaj, në bazë të neneve 4,38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72 dhe 79 të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPP-ës të akuzuarve të lartcekur iu shqipton:

DËNIMIN ME BURGIM DHE DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të akuzuarve A. S. dhe B. G. secilit prej tyre veç e veç iu shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 2 (dy) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej nga 2000 € (dymijë euro) për secilin prej tyre veç e veç, të cilat obligohen ti paguajnë në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë, nuk munden ose nuk janë në gjendje ta paguajnë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'iu zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do t'iu caktohet një ditë burgim.

Të akuzuarit B. G. koha e kaluar në paraburgim nga data 04.04.2023 e deri me datë 20.10.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Të akuzuarit A. S. koha e kaluar në paraburgim nga data 03.04.2023, e deri me datë 30.04.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

I dëmtuari N. D. nga Gjilani, rr. "U. H.", për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohen të akuzuarit që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) dhe në emër të Kompensimit të Viktimave të Krimin, të paguajnë shumën prej nga 20 € (njëzetë euro), të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, në kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 28.4.2023, pranë kësaj gjykate ka dorëzuar aktakuzën PP.II.nr../2023, të datës 27.04.2023, ndaj të pandehurve A. S. nga Gjilani dhe B. G. nga L., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të cilat shqyrtime kanë vazhduar deri më datë 22.02.2024, në të cilin ka prezantuar Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Gjilan, e cila gjatë tërë shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë

aktakuzës së paraqitur, ndajë të akuzuarve, duke i propozuar gjykatës që të njëjtit ti shpall fajtores dhe ti dënoj në bazë të ligjit.

I dëmtuari, N. B., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit dhe si pale e dëmtuar i bashkëngjiten ndjekjes penale ndaje të akuzuarve si dhe parashetrojnë kërkesën pasurore juridike.

Mbrojtësja e të akuzuarit B. G., e caktuar sipas detyrës zyrtare avokatja K. A. S., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë dhe se me asnjë provë të vetme nuk është dëshmuar se i mbrojturi i sajë të ketë kryer veprën penale e cila i bie në barrë, andaj edhe ka kërkuar nga gjykata që të njëjtin ta liroj nga akuza në mungesë të provave.

I akuzuari B. G. A. S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij duke shtuar se ndihet i pafajshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. S., avokati Rr. I., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se aktakuza lëndore përmban shumë parregullsi dhe se nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme se i mbrojturi i tije e ka kryer veprën penale në fjalë, duke i propozuar gjykatës që të nxjerrë aktgjykim lirues në mungesë të provave.

I akuzuari A.S., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështete fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, se është plotësisht i pafajshëm dhe ka kërkuar nga gjykata që të lirohet nga akuza.

Provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor

Pas prezantimit të provave gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit, këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi në bazë të:

- Dëgjimit të të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit N. D. nga Gjilani
- Dëgjimit të dëshmitarit I.V.
- Dëgjimit të dëshmitarit A. D.

-Raporti fillestar i incidentit me nr.2023-CA-..... i datës 02.01.2023, Kallzimi Penal i datës 04.04.2023 dhe kallëzimi penal shtesë i datës 05.04.2023,njoftimi elektronik nga Qendra Korektuese Operative,e datës 19.04.2023,aktvendimi për ndalim ,i datës 01.04.2023,njoftimi lidhur me veprimet hetimore shtesë i datës 06.03.2023,vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht, i datës 05.04.2023,vërtetimi për bastisjen e shtëpisë dhe lokaleve, i datës 04.04.2023,transkripta e bisedave, e datës 14.03.2023,kërkesa e datës 09.04.2023,vendimi për angazhim të ekspertit të datës 06.04.2023,urdhëresa e datës 13.04.2023, kërkesa e datës 04.04.2023,memorandumi zyrtarë i datës 09.04.2023,njoftimi i datës 25.04.2023,raporti i ekspertizës i datës 26.04.2023,vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i datës 04.04.2023,urdhër kontrolli me UGJK,nr.31/23,i datës 03.04.2023,njoftimi lidhur me kontrollin dhe bastisjen e shtëpisë së B. G., i datës 04.04.2023,kërkesa nga Stacioni Policor në Gjilan, e datës 03.04.2023,transkripti në CD, video inxhi imët, të datës 01.04.2023,raporti i oficerit, deklarata e dëshmitarit I.V., e datës 01.09.2023,raporti i oficerit ,me datë 09.01.2023,dhe fotografit nga vendi i ngjarjes, si në shkresat e lëndës,

- Mbrojtja e të akuzuarit B. G. dhe
- Mbrojtja e të akuzuarit A. S..

Deklarata e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit N. B.

I dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit N. B. në seancën e shqyrtimit gjyqësore ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratave të tija të dhëna në Prokurori dhe Polici, duke shtuar se natën kritike sa i kujtohet në janar të vitit 2023, rreth orës 18.00, në shtëpinë e tij me babin në sallon duke shikuar TV kishte dëgjuar krismën e hapjes së derës së ballkonit ka menduar se ishte djali i valluat të tij i cili posa vinte nga puna shkonte në katin e dytë të shtëpisë për ti ndërruar rrobat dhe i njëjti nuk kishte reagu, ka dëgjuar edhe hapjen e dyerve të dhomave dhe në një moment ka hyre vëllai Sh. i cili kishte ardhur nga ordianca dhe pasi kishte pyetur se a është R. lartë dhe ishte informuar se nuk ishte atëherë kishte dalur në korridor dhe kishte thirrur emrin e tij N. e më pas kishte dëgjuar zhurmën e hapave duke u larguar personat nga tarasa dhe kërcyer në druje duke ikur por nuk kishte arritur me i pa. Ka vërejtur se të gjitha dhomat ishin te demoluar si dhe ka vërejtur se i mungon një orë dore e markës Citi Zen, në vlerë prej 1200Dollar në dhomën e tij, 2,3 parfume në vlerë nga 200dollar, të cilët ja kishte sjellur bashkëshortja nga Amerika, ndërsa në dhomën e valluat të tij ishte marr shuma e të hollave në vlere afër 20000€, e po ashtu kishin munguar bizhuteri të llojit Sfarofski edhe një ore dore e kunatës së tij e markës Festina, për të cilën thotë se i është kthyer më vonë nga policia hetuese e të cilën ai vetë e kishte pranuar. Në shtëpinë e tyre nuk kishin pasur kamera por në shtëpinë e fqit të tij B. K., përmes kamerave janë vërejtur personat duke ikur nga shtëpi ja e tij dhe duke hyrë në automjetin e llojit Karavan i kuqë por nuk e din e çfar marke.

Deklarata e dëshmitarit I. V.

Dëshmitari I. V., në seancën e shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se në janar të këtij viti ka qenë në shtëpinë e tij duke pirë qaj në tavolinën e bukës dhe nga dritarja ka dëgjuar se kishte kërcyer dikush me forcë në drunjët të cilët i kishin lënë të paluara ai dhe fqinji i tij Sh., ashtu që e kishte hapur dritaren për ta parë se kush ishte por në moment një njeri i kishte thënë hyr brenda se të vrasë, kishte insistuar ta shikojë prapë atë njeri por ishte errësire, e kishte mbyllur dritaren dhe kishte dalur nga dera e hymjes në terasë të hyrja e shtëpisë së tij ku i kishte vërejtur dy persona, njëri ishte në rrugë duke shikuar nga shtëpia e fqinjit të tij dhe tjetri kishte qenë duke ikur. Ka shtuar se në oborrin e kojshisë kishte qenë një shaktë e papërfunduar dhe personi i dytë i cili kishte pasur rroba të zeza dhe ishte më i plotë duke ikur ishte rrëzuar por prap ishte ngritur në këmbë, kishte dalë në rrugë ishte bërë bashkë me personin tjetër dhe kishin ikur duke vrapuar kishte vërejtur një automjet i parkuar në të cilin kishin hypur ata personi dhe ishin larguar. Më pas kishte shkuar te shtëpi ja e Sh. dhe kishte vërejtur babain e tij që ishte i frikësuar.

Deklarata e dëshmitarit A. D.

Dëshmitari A. D., zyrtar policor, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ka punuar në këtë rast dhe ka zhvilluar hetimet ndaj personave të pandehur që gjenden sot në sallë e të cilët janë hetuar për disa raste e një ndër ta ka qenë edhe rasti i datës 09.01.2023 tek i dëmtuari N. D.. Pasi që në shtëpinë e të dëmtuarit nuk kishte pasur kamera kishin kërkuar dhe kishin gjetur në lagje një kamerë larg shtëpisë së ankuesit rreth 50metra, ku kishin vërejtur veturën e kuqe te tipit Reno për të cilin kishin dyshuar duke e ditur e A. S. e shfrytëzonte këtë veturë dhe pas intervisimit të të njëjtit, A. S. e kishte pranuar se vetura e cila shihej në video inqizim ishte e tij. Po ashtu i pandehuri e kishte konfirmuar se në video shihej duke hypur në veturë me shokun e tij B. G.. Më pasë duke u bazuar në deklaratën e A. kishin bërë kërkesë për bastisjen e banesës së B. G. në Lipjan ku gjatë bastisjes te B. në banesë kishin hasur në një sasi të konsiderueshme të orëve të dorës të cilat ishin konfiskuar si të dyshuara dhe dyshohej se mund të jenë të vjedhura dhe kur i kanë prezantuar të gjitha orët te ankuesi N. D. nga i njëjti ishte

identifikuar një orë dore për të cilën kishte deklaruar se ishte vjedhur në natën kritike e të cilën ja kishin kthyer ankuesit, e që figuron edhe te procesverbali i kontrollit dhe bastisjes në shtëpinë e të pandehurit. Më pas kishin intervistuar edhe B. G. e që i njëjti e kishte mohuar se e ka kryer këtë veprë. Ka shtuar se në video inqizim shihet vetura e llojit Reno me ngjyrë të kuqe e për të cilën A. e kishte konfirmuar se është vetura e tij dhe se ishte i njëjti kur ka hypur në veturë së bashku me B. G. edhe se kjo video ishte pas kryerjes së vjedhjes në shtëpinë e të dëmtuarit N. D.. Po ashtu ka shtuar se gjatë se intervistimit të A. i njëjti e kishte justifikuar se ka qenë me B. dhe arsyeja pse kanë vrapuar dhe kanë hypur në automjet sipas tij ishte se kanë pasur punë personale me disa femra dhe se kjo ikje ishte bërë fill pas rastit të vjedhjes, pra nuk ishte koincidence që në shtëpinë e B. G. të gjendet ora e ankuesit e cila ishte vjedhur në ditën kritike e që ajo orë ishte e kumatës së tij. Deklaron se ora ka qenë e markës F. të cilën e kishte deklaruar ankuesi si të vjedhur e i cili më pas ishte ftuar në stacionin policor për ta parë orën dhe e njëjta ishte kthyer në vërtetim për kthimin e sendeve. B. nuk ka pasur dëshmi për prejardhjen e dy kesëve me ora për të cilat i janë konfiskuar, po ashtu ka shtuar se me vetë faktin që i dëmtuari ka raportuar orën të vjedhur e që ka rezultuar që është gjetur në banesën e B.G. konsideron se është provë.

Deklarata e dëshmitarit L. L.

Dëshmitari L. L. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë raportit të hartuar në vendin e ngjarjes ku kishte qenë me zyrtarin policor M. A. për rastin konkret të dt.09.01.2023 diku rreth orës 19.00 kishin marrë një informatë prej bazës për një vjedhje që kishte ndodhur në një shtëpi në rrugën U. H. e me informata të sakta, me të mbërritur në vendin e ngjarjes kishin takuar ankuesin i cili i kishte njoftuar për rastin duke shtuar se gjerë sa ishte në shtëpinë e tij në sallon kishte dëgjuar një zhurmë nga kati i dytë i shtëpisë pastaj kishte hypur lartë dhe kishte vërejtur se dhoma e tij e fjetjes ishte me derë të hapur dhe me dritare të hapur po ashtu kishte shtuar se kishte dëgjuar një krismë ku kishin kërcyer personat nga dritarja në tokë, i kishte treguar se i mungojnë shumë sende, para të gatshme në vlerë prej 3-4000euro, orë, parfume, bizhuteri etj., po ashtu një fqinjë i cili ishte ngjitur me shtëpinë e ankuesit emri i të cilit nuk i kujtohet kishte treguar se kishte n dëgjuar një krismë të drunjëve, kishte hapur dritaren, i kishte parë dy persona por nuk kishte mundë ti identifikojë, por njëri nga ta i kishte thënë hyrë brenda se të vrajë dhe më pas i kishte parë duke ikur nga aty në drejtim të veturës së tyre, të cilën e kishin parkuar në parkingun e një biznesi privat, dikur rreth 100-150metra larg shtëpisë së ankuesit. Në fund ka shtuar se dritarja ku kanë hyrë të dyshuarit ka qenë e dëmtuar po ashtu edhe dera e asaj dhome kishte qenë e dëmtuar dhe fornzika kishte dalë dhe bërë foto në vendin e ngjarjes.

Mbrojtja e të akuzuarit B. G.

I akuzuari B. G. në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale, se në ditën kritike nuk kishte qenë me të akuzuarin tjetër A. S. të cilin e ka shok të ngushtë dhe se familjet e tyre po ashtu shoqërohen, dhe sa i kujtohet është takuar me A. S. 2-3dite para vitit të ri se ka shkuar ta ngushëlloj për nenën dhe motrën e tij, ndërsa sa i përket orës qe thuhet se është gjetur në shtëpinë e tije e llojit Festina, deklaroi se është e motrës së tij, duke shtuar se vërtetë policia ka konfiskuar një numër të orave të dorës por ato i ka sjellur nga Zvicra dhe se të njëjtat kanë qenë të familjarëve të tij. Po ashtu ka shtuar se nuk e din se A. S. kishte deklaruar se në atë kohë kishte qenë me të por beson se ka qenë një keqkuptim tek policia, dhe shton se orat të cilat janë konfiskuar dhe bizhuteritë janë kthyer për veç një ore të llojit Festina. E ka të njohur faktin se A. S. posedon dy vetura të llojit BMW dhe Renomegano carven ngjyre e kuqe. Nuk e mohon faktin se me A. ka qenë si bashkëkryerës së një vjedhje të vitit 2020 dhe për atë e ka vuajtur dënimin.

Mbrojtja e të akuzuarit A. S.

I akuzuari A. S. në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale, duke shtuar se lidhur me këtë çështje ka dhënë deklaratë në polici dhe prokurori dhe mbetet pranë të njëjtat me përjashtim të deklaramit në polici se B. G. ka qenë me të, por ka thënë se ka mundur me qenë me të, pasi që të njëjtin e njeh që nga viti 2007, në shtetin e Zvicrës i cili kishte punuar në firmën e tij, po në vitin 2016 kishte pësuar një aksident dhe nga ajo kohe merr pension invalidor në shtetin e Zvicrës. Lidhur me ditën kritike deklaroi se nuk e din se ku është tani shtëpia e të dëmtuarit N. D., ndërsa lidhur me video incizimet ka deklaruar se në atë parking shkon shpesh për punët e tija personale. Po ashtu ka deklaruar se i posedon dy automjete njëra me ngjyrë të bardhë dhe tjetra me të kuqe ndërsa lidhur me video incizimin që shihet vetura reno megano deklaroi se nuk ka qenë me B. G., ndërsa me rastin e ballafaqimit me deklarate e tij të dhënë me datën 01.04.2024 nga ana e prokurores së shtetit se çka keni kërkuar në atë rrugë dhe me kënd keni qenë deklaroi se është vetura e tij që po e sheh në video incizim, por nuk ka qenë me B. G. por ka mundur të jetë me J. K. nga Sh. e për të cilin nuk është i sigurt, po ashtu deklaroi se vetura e cila shihet në video incizim është e tij por arsyeja pse ka qenë në atë vend ka qenë se ishte për shkak të një dashnoreje jashtë martesore dhe për këtë arsye kishte nguruar të flasë.

Përmbajtja e provave materiale

Nga leximi i provave materiale si deklaratat e te pandehurve te dhëna ne Prokurori, Raporti fillestar i incidentit me nr.2023-CA-... i datës 02.01.2023, Kallëzimi Penal i datës 04.04.2023 dhe kallëzimi penal shtesë i datës 05.04.2023, njoftimi elektronik nga Qendra Korrektuese Operative, e datës 19.04.2023, aktvendimi për ndalim ,i datës 01.04.2023, njoftimi lidhur me veprimet hetimore shtesë i datës 06.03.2023, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht, i datës 05.04.2023, vërtetimi për bastisjen e shtëpisë dhe lokaleve, i datës 04.04.2023, traskripta e bisedave, e datës 14.03.2023, kërkesa e datës 09.04.2023, vendimi për angazhim të ekspertit të datës 06.04.2023, urdhëresa e datës 13.04.2023, kërkesa e datës 04.04.2023, memorandumi zyrtarë i datës 09.04.2023, njoftimi i datës 25.04.2023, raporti i ekspertizës i datës 26.04.2023, vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve ,i datës 04.04.2023, urdhër kontrolli me UGJK.nr.../23,i datës 03.04.2023, njoftimi lidhur me kontrollin dhe bastisjen e shtëpisë së B. G., i datës 04.04.2023, kërkesa nga Stacioni Policor në Gjilan, e datës 03.04.2023, traskripti në CD, video inxhi imët, të datës 01.04.2023, raporti i oficerit, deklarata e dëshmitarit I. V., e datës 01.09.2023, raporti i oficerit ,me datë 09.01.2023, dhe fotografit nga vendi i ngjarjes, si në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se nga të njëjtat është vërtetuar se të akuzuarit B. G. dhe A. S. kanë kryer veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Nga raporti i oficerit me numër 2020-CA-...., të datës 09.01.2023, gjykata vërteton faktin se i dëmtuari kishte raportuar një rast vjedhje duke cekur se duke qëndruar në dhomën e ndejës në shtëpinë e tij, kishte dëgjuar një krismë që ishte dëgjuar nga kati i II, e me të hipur nalt në dhomën e tij personat e pa njohur kishin kërcyer nga ballkoni dhe kishin ikur, kishte raportuar se kishin vjedhur 1000 euro, para të metalta (1-2 euro) dhe gjësende tjera personale si orë dore. Bizhuteri, parfume dhe vlerë të përgjithshme 300-400 euro, ku më pas në vendin e ngjarjes kishte dalur njësia e forenzikës e cila kishte bërë vend shqimin.

Nga raporti i Policit me numër të rastit 2023-CA-...., i përpiluar nga Zyrtari Policor-Hetuesi, L. L., gjykata gjeti se njësiti i hetimeve pas pranimit të rastit, kishte filluar me punën operacionale ku fillimisht ishin takuar me ankuesin N. D. i cili i kishte njoftuar në lidhje me rastin i cili fillimisht kishte dëgjuar një krismë që vinte nga dhoma e tij dhe pastaj kishte parë që persona të panjohur kishte kërcyer nga ballkoni i dhomës së tij, ku vëreheshin dëmtimet që ishin bërë

në derë dhe dritare të asaj dhome e po ashtu dëshmitari I. V. i cili ishte fqinjë i ankuesit i cili kishte dëgjuar krismën dhe kishte dalë në dritare e më pas i kishte parë dy persona po për arsye të errësirës nuk kishte mundur ti identifikonte por personi i cili ishte tek dritarja me të parë I.. i kishte thënë ik more se të vrajë duke i drejtuar dorën nga ai e më pas kishin vazhduar në drejtim të një veture e cila ishte e parkuar në parkingun e një biznesi privat, dhe vetura ishte ford ngjyrë e kuqe por targat nuk i shiheshin në këtë rast ishin vjedhur para të metalta dhe gjësende tjera personale e që vlera e përgjithshme ishte 3400 euro.

Nga njoftimi lidhur me veprimet hetimore shtesë, lidhur me rastin 2023-CA-.. nga NJHK ,i datës 01.04.2023 gjykata vërtetoi gjeti se ditën kritike i pandehuri A.S.i nga ana e hetueseve ishte ballafaquar me një video incizim të datës 09.01,2023, rreth orës 18:45 ku shihet vetura Reno Megano me ngjyrë të kuqe dhe shihen dy persona me dorëza të bardha në duar duke ikur dhe duke hypur në atë veturë dhe se i pandehuri A. S. kishte pranuar se vetura në fjalë ishte e tijë dhe se atë natë kishte qenë së bashku me shokun e tij B. G., ku më pas NJHK kishte bërë kërkesë për urdhër bastisje në banesën e të pandehurit B. G. dhe me datën 04.04.2023, kishin konfiskuar sendet që dyshohej se mund të jenë të vjedhura e të cilat i kishin sekuestruar dhe me t. 05.04.2023 kishin kontaktuar ankuesin N. D. të cilin ja kishin prezantuar ora te dorës që i kishin sekuestruar në banesën e B. G., në këtë rast ankuesi N. D. e kishte identifikuar orën e markës festina, më pas edhe në zyrat e NJHK-së kishte bërë identifikimin e orës së dorës e cila ishte vjedhur me dt. 09.01.2023, e cila orë ishte gjetur në banesën e të dyshuarit B. G. në vitrinë.

Vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht, me nr. të rastit 2023-CA-., të datës 05.04.2023, nga NJHK.

I akuzuari A. S. ishte intervistuar nga zyrtari policor A. D., për rastin në fjalë vjedhje e rëndë dhe gjatë shqimit të videoinxhizimit kishte pranuar se në atë videoinxhizim është vetura e tij dhe se në atë momente ka qenë së bashku me shokun e vet B. G. por se vjedhje nuk kanë kryer, ndërsa lidhur me faktin se pse kanë vrapuar si në video A. ka deklaruar se është çështje personale e tij, ndërsa i akuzuari B. G. gjatë intervistimit nuk kishte pranuar fare se atë natë kishte qenë me A. dhe kishte mohuar çdo gjë. Ndërsa lidhur me këtë rast fqinji i ankuesit I. V. kishte dhënë një deklaratë të dëshmitarit ku kishte deklaruar se kishte parë dy persona qe kishin dalë nga shtëpia e ankuesit dhe njëri prej tyre e kishte kanosur dhe më pas ishin larguar në drejtim të rrugës kryesore e që i kishte parë duke hipur në veturën e kuqe.

Hetuesi policor A. D. ka cek se ankuesi i rastit në fjalë kishte arritur që të identifikoj edhe një orë dore të markës festina e cila ishte vjedhur në këtë rast dhe ishte gjetur e konfiskuar në banesën e B. G..

I akuzuari B. G. ishte intervistuar nga zyrtari policor A. D., për rastin në fjalë vjedhje e rëndë, i njëjti ka deklaruar se me A. njihet dikur prej vitit 2007, në shtetin e Zvicrës dhe se shoqërohen familjarisht. Më parë kishte qenë i dënuar për një vjedhje në bashkëkryerje me A. S., ku edhe e kishte vuajtur dënimin. Pas daljes nga burgu është takuar me A. para 3 muajve për ngushëllime për nënën dhe motrën. E ka të njohur faktin se A. i ka dy vetura njëra BMW me ngjyrë të bardhë dhe tjera me ngjyrë të kuqe nuk i kujtohet data por e din se me këtë veturë janë shëtitur me A. nëpër Gjilan. Pasi ju është prezantuar video inxhizimi nga ana e zyrtarit policor dhe pas njoftimit që A. ka deklaruar se ka qenë me të njëjtin në atë video, nuk e kishte pranuar se kishte qenë ditën kritike me A. dhe nuk e din arsyen pse i njëjti ka deklaruar se në atë video kanë qenë bashkë, ndërsa lidhur me atë se gjatë kontrollit në shtëpinë e tij që janë

gjetur disa sende ora dore, hallka bizhuteri e gjësente të tjera që kishin qenë ne për gjepa të jakneve të tij ka deklaruar se kanë qenë të familjarëve të tije.

Nga deklarata e dëshmitarit I. V. e dhënë në stacionin Policor në Gjilan me datë 09.01.2023, pranë të cilës deklaratë i njëjti ka mbetur në tërësi edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata gjeti si i njëjti kishte deklaruar se me datë 09.01.2023, kishte qenë brenda në sallonin e ndejës të shtëpisë së tij ku kishte dëgjuar një krismë dhe ishte afruar tek dritarja, e kishte hapur për të shikuar se çfarë krisme ishte ajo dhe me të hapur dritaren e kishte parë një person ku i kishte thënë ik more se të vrasë, duke ia drejtuar dorën por nuk e ka parë se a ka pasur armë pasi që ishte errësirë, e po ashtu në atë moment e kishte parë një person tjetër në oborrin e një shtëpie fqinju e cila ishte e pa banuar e i cili po ikte në drejtim të rrugës kryesore, më pas kishte dalë te dera e hyrjes së shtëpisë dhe i kishte parë duke ikur ata dy persona, dhe hipur në veturën e parkuar në një parking të një biznesi privat, më pas kishte vërejtur se dy druje të vogël të fqinjtit të tij Sh. D. kishin rënë në oborrin e tij dhe ishte afruar tek shtëpia e fqinjtit dhe e kishte pyetur i cili i kishte treguar se kishin hyrë hajnat .

Nga foto dokumentacioni i raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, njësia e forenzikës, i dt. 10.01.2023, gjykata gjeti se në shtëpinë e të dëmtuarit N. D. përkatësisht në fotot e dritave dhe të dyerve, gjykata gjeti se të njëjtat ishin të hapur por që nuk kishte shenja se e njëjta ishte hapur me përdorimin e mjeteve të forta, ndërsa nga fotot gjykata gjeti se shtëpia e të dëmtuarit ishte demoluar si pasojë e vjedhjes që kishte ndodhur.

Nga vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht me nr të rastit 2023-CA-..... i dt. 05.04.2023, i cili gjendet në shkresat e lëndës gjykata gjeti se zyrtari policor K. A. nga stacioni, njësia NJHK, i kishte kthyer sendet – një orë dore e firmës festina me nr serik F1..... personit tani të dëmtuarit N. D. nga Gjilani e cila orë ishte gjendur në shtëpinë e të dëmtuarit B. G..

Nga fotografitë e marra nga videoincizimet e kamerave të sigurisë, gjykata gjeti se personat të cilët gjendet në këto fotografi, përputhen me përshkrimet e bëra nga dëshmitari- Zyrtari policor A. D. i cili në bazë të kamerës larg shtëpisë së ankuesit larg 50m ka vërejtur veturën e kuqe të tipit Reno e në video shihet A. S. duke hipur në veturë me shokun e tij B. G..

Vendimi lidhur me ricilësimin juridik të veprës penale nga vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës në veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare së pari bërë ri cilësimin juridik të veprës penale nga vjedhje e rëndë neni 315 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës ashtu siç është ngritur akti akuzues, në veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, ngase në rastin konkret gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve A. S. dhe B. G. nuk janë përmbushur elementet e veprës penale e cila sipas aktakuzës së prokurorisë i binte në barrë.

Në nenin 315 paragrafi 2 të KPRK-së është paraparë se “*Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1 i nenit 313 ose neni 314 të këtij Kodi ose paragrafi 1 të këtij neni dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet nëse:*” ndërsa në nën paragrafi 2.1 të po këtij neni është paraparë se “*pasuria apo shërbimi i vjedhur ka vlerë mbi pesëmijë (5.000) Euro*” ashtu që inkriminimi i vjedhjes së rëndë është përcaktuar në dy paragrafë. Në paragrafin e parë janë paraparë format e vjedhjes nga neni 315 par. 1 të cilat marrin formën e kualifikuar apo forma të

rënda të veprës penale të vjedhjes për shkak të mënyrës dhe rrethanave të kryerjes, çka nënkupton se për tu përmbushur elementet e kësaj vepre penale, vjedhja e kryer duke thyer me forcë ndërtesat e mbyllura, dhomat, arkat ose sëndukët a hapësirat tjera të mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme. Thyerja me forcë të hapësirave të mbyllura nënkupton hapjen, depërtimin, përvetësimin e pengesave dhe hyrjen me forcë në objektet e mbyllura apo hapësira të mbyllura pa vullnetin e pronarit apo të poseduesit, e që në rastin konkret ndaj të akuzuarve A. S. dhe B. G. me asnjë provë nuk është vërtetuar se të njëjtit kanë kryer format e lartcekura duke shtuar këtu faktin se vetë i dëmtuarit ka deklaruar se ka dëgjuar lëvizjet por ka menduar se është djali i vëlla ut të tije R... i cili në atë kohë kthehej nga puna, nuk kishte dëgjuar me rastin e vjedhjes së shtëpisë së tije ishte hapur diçka me forcë ngase dera e shtëpisë së tyre nuk ishte e siguruar apo e mbyllur me qelës. Në nën paragrafin 1 të paragrafit 2 të këtij neni është paraparë vjedhja e pasurisë, vlera e së cilës kalon shumë e caktuar, pra kjo formë e vjedhjes së kualifikuar ka të bëjë, kryesisht, me vlerën e pasurisë së luajtshme të vjedhur, e sipas këtij nën paragrafi është përcaktuar mbi 5.000 euro, por që gjykata pas vlerësimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, si dhe dëgjimit të palëve në procedurë gjyqësore gjeti se nuk ka prova me të cilat do të vërtetohej vlera e sendeve të vjedhura, andaj gjykata erdhi në përfundimin se në rastin konkretë kemi të bëjmë me veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, ngase të pandehurit me veprimet e tyre nuk kanë mënjeluar pengesat me forcë në hapësire të mbyllur apo me veprimet e tyre nuk kanë krijuar qasje në hapësira të mbyllura e po ashtu nuk është vërtetuar se të njëjtit me veprimet e tyre kanë vjedhur pasuri që ka vlerë mbi pesëmijë (5.000) euro.

Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, gjykata komfor nenit 7 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarve dhe ato në favor të tyre duke i mundësuar të akuzuarve A. S. dhe B. G., shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç'rast gjykata ka ardhur në përfundim se mbrojtjes së të akuzuarve të dhënë në shqyrtim gjyqësor nuk duhet ti falet besimi ngase të njëjtat nuk janë në harmoni të plotë edhe me provat e tjera personale dhe materiale të cilat janë administruar nga ana e gjykatës dhe të cilat tregojnë një gjendje faktike tjetër nga ajo për të cilën të akuzuarit kanë pretenduar, çka rrjedhimisht sipas bindjes së gjykatës vërtetohet e kundërta e pretendimeve të të akuzuarve.

Në këtë çështje penalo juridike gjykata gjeti se me datë 09.01.2023, në periudhën kohore nga ora 18:45 minuta, në rrugën “ U. H. ”, nr. Gjilan, , kishte ndodhur një vjedhje në pronën e të dëmtuarit N. D., ngase një fakt i tillë vërtetohet nga deklaratat e vetë të dëmtuarit dhe dëshmitarëve, e po ashtu edhe nga provat materiale të cilat gjendjen në shkresat e lëndës. Nuk ishte kontestuese fakti se në periudhën e njëjte kohore kur kishte ndodhur vjedhja në shtëpinë e të dëmtuarit N. B., të akuzuarit A. S. dhe B. kishin qenë prezent afër pronës së tyre, ngase një fakt të tillë e vërteton dëshmitari I. V.. i cili i kishte pasi kishte dëgjuar krismën e drunjtëve kishte hapur dritaren e që i kishte identifikuar dy persona ku njeri prej tyre e kishte kërcënuar duke i thënë : hyr brenda se të vrahë, por figurat e tyre për shkak të errësirës nuk kishte arritur ti identifikojë edhe pse e mohojnë të akuzuarit por se një gjë e tillë është në përputhje me intervalin kohorë të vërtetuar në bazë të video incizimeve të kamerave të sigurisë, e po ashtu nuk ishte kontestuese se natën kritike i akuzuari A. S. me vrap kishte hipur në veturën e tije të Llojit Reno Megano, ngase të njëjtën e pohon vetë i akuzuari A. S.. Kontestuese në këtë çështje

penalo juridike ishte nëse ditën kritike këtë vjedhje e kishin kryer të akuzuarit B. G. dhe A. S.. Andaj, gjykata i ka vlerësuar me kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se duhet ti falet besimi i plotë provave të propozuara nga prokurori i shtetit të cilat në tërësi e vërtetojnë dyshim e bazuar mirë se të akuzuarit e lartcekur, e kanë kryer veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që të gjitha provat e prezantuara në shqyrtim kanë lidhmëni logjike, kohore dhe janë bindëse dhe të qarta dhe janë në harmoni të plotë si me dëshmitë e dëshmitarëve ashtu edhe me provat e tjera materiale.

Gjykata deri tek një përfundim i tillë erdhi duke u bazuar në deklaratën e të dëmtuarit N. D., i cili në mënyrë të detajuar e ka përshkruar se si në ditën kritike derisa ka qenë në shtëpi në katin e parë ka dëgjuar zhurmë në katin e dytë dhe i kishte dëgjuar hapat duke vrapuar ku personat që kishin kryer vjedhjen kishin kërcyer nga ballkoni në tokë duke kaluar përmes fqinjit të tije tani dëshmitarit I.V., e i cili e konfirmoi se ditën kritike kishte vërejtur dy persona të cilët nga oborri i fqinjit të tije kishin kaluar duke vrapuar dhe se njëri prej tyre ishte rrëzuar e më pas kishin hipur në një veturë dhe ishin larguar, deklarata këto të cilat janë në përputhje edhe me deklaratimet e hetuesit policor A. D., i cili pranë kësaj gjykate i ka sqaruar veprimet hetimore të ndërmarra në këtë çështje penale në bazë të së cilave edhe i ka identifikuar kryerësit e kësaj veprë penale e që nëpërmes video inxhizimeve të marra nga vendi i ngjarjes kanë identifikuar veturën e markës Reno me ngjyrë të kuqe, e cila ka rezultuar se ishte pronë e të akuzuarit A. S., e i cili pas intervistimit ka konfirmuar se ka qenë me të akuzuarin B. G., e që pas kësaj informate ka shkuar në bastisje në shtëpinë e të akuzuarit për bastisje dhe se gjatë bastisjes ndër të tjera ishte gjetur edhe ora e dorës e markës Festina e cila ishte njëra prej sendeve të vjedhura në shtëpinë e të dëmtuarit e të cilën orë e ka identifikuar kunata e të dëmtuarit e cila ishte pronare e sajë, fakt i cili u vërtetua edhe nga fotoja e cila gjendet në shkresat e lëndës. Deklaratat e dëshmitarëve të lartcekur janë në harmoni dhe përputhje të plotë edhe me video incizimet e prezantuara nga Prokuroria Themelore në Gjilan, e të cilat incizime janë administruar edhe gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor ngase të njëjtat incizime kanë lidhshmëri kohore me kohën e kryerjes së veprës penale, po ashtu vetë i akuzuari A. S. i cili në tri deklaratat e tije ka qenë kundërtënë por e kishte pranuar se ka qenë në veturën e tije në kohën dhe vendin kur kishte ndodhur vepra, foto të marra nga kamerat e sigurisë, si dhe fakti se si u gjete në shtëpinë e të akuzuarit B. G. ora e dorës e cila ishte vjedhur në shtëpinë e të dëmtuarit. Gjykata deri tek një përfundim i tillë erdhi edhe duke u mbështetur në video incizimet e kamerave të sigurisë, të cilat janë marrë nga organet e ndjekjes. Gjykata ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarve A. S. dhe B. G., të cilave nuk ia fali besimin pasi që këto ishin në kundërshtim të plotë me provat e administruara në seancat e shqyrtimit gjyqësor, e gjithë kjo me qëllimin për ti ikur përgjegjësisë penale.

Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike se të akuzuarit A. S. dhe B. G., kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe të njëjtëve i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit, pasi që ka bërë ricilësimin juridik të veprës penale nga vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës në veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, ka vlerësuar se të akuzuarve duhet ti shqiptohet secilit veç e veç dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 2

(dy) vite të cilat dënime do ti mbajnë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë si dhe dënim me gjobë në shumë prej nga 2000 € (dymijë euro) për secilin prej tyre veç e veç, të cilat obligohen ti paguajnë në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesve dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të dy të akuzuarit gjeti sjelljen e tyre gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarit gjykata morri mënyrën e kryerjes së veprës penale, pastaj natyrën e veprës penale si dhe veprimet paraprake të cilat të pandehurit i kanë bërë para se të kryenin veprën penale, po ashtu gjykata mori parasysh edhe rrethanat personale, karakteristikat si dhe sjelljen e mëparshme të të akuzuarve pasi që të njëjtit edhe më parë në bashkëkryerje kanë kryer vepër penale të njëjte, andaj duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë gjykata konsideron se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarve po ashtu gjykata konsideron se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Llogaritja e kohës së kaluar në paraburgim

Gjykata komfor nenit 79 paragrafi 1 të KPRK-së, të pandehurve A.S. dhe B. G., kohën e kaluar nën masën e paraburgimit ua llogariti në dënimin e shqiptuar me burgim.

Zëvendësimi i dënimit

Duke u bazuar në nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së, nëse të akuzuarit refuzojnë të paguajnë dënimin me gjobë ose nuk janë në gjendje ta paguajnë atë, atëherë dënimi me gjobë do t'iu zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do t'iu caktohet një ditë burgim.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarit E.B. dhe N. B., i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko-civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarve, gjykata duke u bazuar në nenin 450 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarit veç e veç ti obligojë që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) për secilin prej tyre veç e veç si dhe në bazë të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga 20 € (njëzet euro), për secilin prej tyre veç e veç të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.294/23, me datë 22.03.2024

Gjyqtarja e vetme gjyquese,
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.